REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 112/26 Dt. 05.03.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) të Rregullores (QRK) nr. 06/2023 për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimi, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Zyrës për Komunitete dhe Kthim, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për lejimin e udhëtimit zyrtar

1. Miratohet kërkesa e Zyrës për Komunitete dhe Kthim për lejimin e udhëtimi zyrtar të zyrtarëve komunal, si në vijim: Derya Kala, Igballka Rama Fazlija dhe Asim Imeri, për vizitë zyrtare në Republikën e Serbisë, me qëllim të selektimit të përfitueseve në Komunën e Prizrenit, si dhe marrjes së dokumenteve personale të personave të riatdhesuar.

2. Vizita do të realizohet nga data 30 mars 2026 deri me 02 prill 2026, në Republikën e Serbisë, kështu që, për këtë qëllim, lejohet udhëtimi zyrtar, mbulimi i shpenzimeve të ushqimit, të akomodimit, të transportit dhe pagesa e mëditjeve për të lartcekurit.

3. Për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar me makinë zyrtare të Komunës së Prizrenit.

4. Shuma e lejuar, e përshkruar në këtë Vendim, do të sigurohet nga buxheti i Komunës - pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit dhe Komunës dhe mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

5. Obligohet Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Zyrës për Komunitete dhe Kthim,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Të lartcekurve,
- Arkivës së Kryetarit.